

2/15/2024

RAPORT TEKNIK

I VLERESIMIT TE NDIKIMIT NE MJDIS

Hartoi raportin: MSc. Ing. Denisa Kola

Denisa
TIRANE 2024

Projekti:	Zëvendësim paisje elektrike brenda objektit hidroenergjitik, ndryshim gjeneratori për rritje kapaciteti "HEC – SELCA" Me vendndodhje: Në fshatin Selcë, Njësia Administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe, qarku Shkodër
Baza Ligjore:	Raporti teknik bazohen në kërkesat e VKM nr. 686, datë 29.07.2015 "Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së vlerësimit të ndikimit në mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të vendimit e deklaratës mjedisore", (të ndryshuar).
Klasifikimi sipas Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 "Për vlerësimin e Ndikimit në Mjedis" të ndryshuar	Shtojca II, pika 3/ë "Instalime për prodhimin e energjisë hidroelektrike".
Zhvilluesi:	Selca Energji sh.p.k

Përmbajtja:

1. Qëllimi i projektit të propozuar4
2. Planimetritë e vendodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit kordinativ Gauss Kruger, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohesisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë4
3. Informacion për qëndrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti6
4. Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektit, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit7
5. Përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit13
6. Informacion për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rruget ekzistuese të aksesit apo nevojen për hapje të rrugeve të reja13
7. Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit14
8. Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji)14
9. Informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit14
10. Informacion për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret15
11. Të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre15
12. Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj16
13. Informacion i detajuar për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/licensimin e projektit16

14. Të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës ku do të zhvillohet projekti	28
---	----

Lista e Figurave:

Figure 1: Vendndodhja e HEC Selcës	5
Figure 2: Harta e zonave urbane.....	6
Figure 3: Harta me largesitë e godinës së HEC-it nga qendrat e banuara më të afërta.....	7
Figure 4: Foto të godinës së HEC-it.....	9
Figure 5: Skema elektrike principale e HEC-it.....	9
Figure 6: Plan rievimi i nenobjekteve të HEC-it	Error! Bookmark not defined.
Figure 7: Skema e vendosjes së HEC-it	Error! Bookmark not defined.

Lista e Tabelave:

Table 1: Të dhënat e aktivitetit	4
Table 2: Koordinatat e HEC Selcës	5
Table 3: Të dhënat teknike të projektit dhe të gjeneratorit të ri	11

1. Qëllimi i projektit të propozuar

Prodhimi i energjisë elektrike nga burimet e rinovueshme është një nga objektivat ndërkombëtare për reduktimin e burimeve ndotëse në mjedis. Shqipëria është një vend i pasur me trupa ujorë sipërfaqësorë (lumenj, përrenj) ku pjesa më e madhe e tyre formohen në territorin Shqiptar. Këto resurse kanë bërë që vendi ynë të orientohet drejt ndërtimit të veprave hidroenergjetike.

Projekti në studim synon rritjen e kapacitetit të prodhimit të energjisë duke ndërruar një paisje të tipit gjenerator që ndodhet brenda godinës ekzistuese të HEC SELCES pa kryer asnjë lloj punimi ndërtimor. Aktualisht HEC Selca punon me kapacitet 1600 KW dhe do të shkojë në 1980 KW me ndërrimin e gjeneratorit.

Table 1: Të dhënat e aktivitetit

Projekti	Zëvendësim Gjeneratori për rritje kapaciteti "HEC Selca"
Vendndodhja	Lumi Cem i Selcës & Përroi i Sllapit, Bashkia Malësi e Madhe
Zhvillues	Selca Energji sh.p.k
Kapaciteti i fuqisë së instaluar	1600 KW
Kapaciteti i fuqisë që do të shtohet	380 KW
Kapaciteti total i fuqisë së HEC-it	1980 KW
Frekuenca	50 Hz
Shkarkimi	1 x 1.18 m ³ /s
Tensioni i telit	6300 V
Shpejtësia e vlerësuar	428.6 rpm
Fuqia e gjeneratorit	1 x 1100 kW
Efikasiteti i gjeneratorit	94 %

2. Planimetritë e vendodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit kordinativ Gauss Kruger, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkoheisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë

Hidrocentrali ne fjale eshte ekzistues dhe ne funksion, ai shfrytëzon ujerat në lumin Cem i Selcës dhe ujërat në përroin e Sllapit, për të cilat disponon lejet përkatëse për shfrytëzim të

burimit uhor me vendndodhje në Fshatin Selcë, Njësinë Administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe, Qarku Shkodër.



Figura 1: Vendodhja e HEC Selces

Tabla 2: Koordinatat e HEC Selces

HEC Selca			
Vepra e Marrjes Cem i Selcës			
KRGJSH		GAUSS KRUGER	
E	468280.65	E	4386226.70
N	4708539.34	N	4709530.23
Vepra e Marrjes Përroi i Sllapit			
KRGJSH		GAUSS KRUGER	
E	466503.60	E	4384466.76
N	4709509.05	N	4710513.62
Godina e Hec-it			
KRGJSH		GAUSS KRUGER	
E	467062.99	E	4385004.00
N	4708122.51	N	4709128.00

3. Informacion për qëndrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti

Zona e projektit të HEC Selcës shtrihet në pjesën Veriore të qytetit të Shkodrës, në fshatin Selcë të Malësisë së Madhe, projekti në fjalë shfrytëzon ujerat e Lumit Cemi i Selcës dhe ujërat e përroit të Shllapit, për të cilat subjekti Selca Energji disponon lejet përkatëse për përdorim të rezervave ujore për prodhim hidroenergjie. Konkretisht leja që subjekti disponon për Lumin Cem i Selcës është e vlefshme për një afat kohor deri në datën 05.04.2040, kurse leja për përroit të Shllapit është për një afat kohor deri në 09.06.2043 të dyja këto leje janë dhënë me Vendim të Këshillit të Basenit Ujëmbledhës Drine-Bunë. Objekti/ godina e HEC-it është e ndërtuar pasi siç e kemi përmendur ky HEC është në funksionim. Në afërsi të godinës së HEC-it nuk ka qendra të banuara dhe pse nga funksionimi i këtij aktiviteti nuk ka asnjë lloj ndikimi në popullsi.



Figura 1: Harta e zonave urbane



Figura 3: Harta me largesite e godines se HEC-it nga qendrat me te aferta te banuara

Siç mund të duket edhe nga figurat e mesiperme në të cilat duket qarte që në afërsi me godinën e HEC-it nuk ka qendra të banuara dhe pse zonat e banuara me të afërta ndodhen të distancuara.

Njësia Administrative ku bën pjesë projektin në fjalë, sipas Ligjit Nr. 115/2014 "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", zona e projektit bën pjesë në njësinë administrative Kelmend, Bashkia Malësi e Madhe.

4. Skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektit, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit

Projekti në fjalë është ekzistues (hec ekzistues i privatizuar, në pronësi të shoqërisë Selca Energji shpk) dhe në funksionim me një kapacitet të instaluar 1600 KW i licencuar nga Enti Rregullator i Energjisë. Siç e kemi përmendur energjia elektrike është mjaft e kërkuar në kohën që ndodhemi. Për të shfrytëzuar me një efikasitet maksimale prurjet e ujit në Hec si dhe për shkak të amortizimit të njerës paisje investitorët/pronarët e HEC Selcës kanë planifikuar që të zevëndësojnë një nga gjeneratorët ekzistues me një gjenerator të ri duke

rritur kështu fuqinë e Hec-it. Theksojmë që turbina dhe vepra e marrjes ekzistuese janë të projektuara dhe instaluar për të përballuar këtë rritje fuqie prej 380 kw. Hidrocentrali ka të instaluar 4 njësi gjeneruese: Turbinë Pelton 630 KW, Turbinë Pelton 50 KW, Turbinë Francis 200 Kw, dhe Turbinë Pelton me gjenerator 720 KW. Kjo e fundit ka një kapacitet prodhues 1100 KW por deri tani ka qënë e lidhur me një gjenerator me fuqi 720 KW, duke rezultuar në një output të kësaj turbine prej 720 KW. Pas konsultimit me inxhinierin elektrik, për një shfrytëzim më të mirë të veprës së marrjes ekzistuese si dhe të vetë kapacitetit të turbinës, shoqëria mendon të bëjë ndërrimin e gjeneratorit të vjetër me një të ri me fuqi 1100 KW, duke rritur kapacitetin total të instaluar në hidrocentral me 380 KW, nga 1600 KW në 1980 KW. Theksojmë që Pika dhe Skema e Lidhjes së Hec-it nuk do të ndryshojë në këtë proces, si dhe nuk do të kryhet asnjë ndryshim ose punim ndërtimor në veprat e marrjes apo në godinën e Hec-it. Gjeneratori që do të zëvendësohet është brenda godinës ekzistuese të Hec-it.

Hidrocentrali Selcës referuar projektit ekzistues dhe funksionimit ka si pjesë përbërëse të tij këto këto nënobjekte:

- *Veprat e Marrjes (Vepra e marrjes në Lumin Cem i Selcës dhe Vepra e marrjes në Përroin e Sllapit)*
- *Kanal betoni devijimi në sipërfaqe*
- *Tubacione të turbinave*
- *Basene Presioni*
- *Ndërtesa e turbinave/ ndërtesa e HEC-it*

Nga sa me sipër të gjitha nënobjektet e HEC-it janë ekzistuese dhe në to nuk do të ketë asnjë punim ndërtimor të ri.





Figura 4: Foto e godinës së HEC-it

Skema e hidrocentralit të Selcës

Skema e Hidrocentralit të Selces është e përqendruar në dy vepra marrje një në Lumin Cem i Selces dhe një në Përroin e Sllapit, sipas lejeve që subjekti disponon. HEC-i është ekzistues dhe në funksionim, në të nuk do të bëhet asnjë lloj ndërtimi i ri vetëm zevëndësimi i një paisje (gjenerator) e cila njëkohësisht do të rrisë edhe kapacitetin prodhues të energjise elektrike nga 1600 KW në 1980 KW.




Figura 5: Skema elektrike principale e HEC-it




Figura 6: Plan rievimi I nenobjekteve t e HEC-it

Bazuar edhe në kushtet e veçanta të përdorimit të skemave elektrike, duke u bazuar në prurjet shfrytëzuese të ujit sipas lejeve perkatëse që Selca Energji disponon sipas skemes elektrike principale unifikare të figurës më sipër tregon që me ndërrimin e gjeneratorit të vjetër me gjeneratorin e ri mund të bëhet rritja e prodhimtarisë/eficencës nga 1600 KW – 1980 KW pa pasur nevojë për asnjë lloj punimi ndërtimor shtesë.

Skema e shfrytëzimit hidroenergjetik

Shfrytëzimi hidroenergjetik i në Lumin Cem i Selcës dhe në përroin e Sllapit është bërë dhe vazhdon të bëhet nëpërmjet Hidrocentralit të Selcës nga subjekti Selca Energji shpk me NIPT: K98510701M që disponon lejet dhe autorizimet perkatëse. Hidrocentrali Selcës në

këtë moment ka të instaluar fuqinë 1600 KW dhe me ndryshimin e një paisje që do të bëj do të shkoj në fuqinë 1980 KW.




Figura 7: Skema e vendosjes së HEC-it

Tabla 3: Te dhenat teknike te projektit dhe te gjeneratorit te ri

Projekti	Zëvendësim Gjeneratori për rritje kapaciteti "HEC Selca"
Vendndodhja	Lumi Cem i Selcës & Përroi i Sllapit, Bashkia Malësi e Madhe
Zhvillues	Selca Energji sh.p.k
Kapaciteti i fuqisë së instaluar	1600 KW
Kapaciteti i fuqisë që do të shtohet	380 KW
Kapaciteti total i fuqisë së HEC-it	1980 KW
Frekuenca	50 Hz
Shkarkimi	1 x 1.18 m ³ /s
Tensioni i telit	6300 V
Shpejtësia e vlerësuar	428.6 rpm
Fuqia e gjeneratorit	1 x 1100 kW
Efikasiteti i gjeneratorit	94 %

Procese ndërtimore në këtë projekt, nuk do të ketë pasi godina e HEC-it është e ndërtuar dhe funksionale, siç e kemi përmendur edhe më sipër në këtë aktivitet do të bëhet vetëm ndryshimi i një paisje (gjenerator) për të shtuar në këtë mënyrë edhe prodhimin e energjisë. Gjeneratori i ri është porositur në Kinë dhe me paisjen e subjektit me lejet përkatëse do të nisë puna për instalimin e tij. Më poshtë në mënyrë tabelore po japim dhe specifikimet teknike bashkë me ofertën financiare për blerjen e gjeneratorit të ri.

From: Mr. Fang E-mail: hydropowerstation@163.com				Date: 5th Feb .2024			
To: Selca Energji shpk- Sebastian Pjetri E-mail: selcaenergji@yahoo.com							
Frequency	F	50	HZ	generator efficiencv	llg	94	%
Rated speed	n	428.6	r/min	Outlet voltage		6300	V
Generator Output	Ng	1100	kw				
Price of equipments and serives							
S.N	Name of equipment and specifications			Unit price	Qty	Total	
1.2	synchronous generator SFWE-W1100- \$ 14/1730(Brushless exciter. 0.8pf 6300kv)			115.000.00	1	\$115,000.00	
	Total CIF Durres					\$115,000.00	
1.Terms of payment By Tff or UG30% as advance payment within 20 working days after contract,70% by UC or by TT after the goods delivery against shipping documents scan copy							
2. Delivery time: within 6 months after advance payment received and contract taking into effect							
3. Guarantee/Warranty time: 1 year from the date of commissioning or 18 months from the date of dispatch of last consignment whichever is earlier							
4. Supervision commissioning and testing training is based on USD150/day per person, and customer should bear the cost of round-trip economic class ticket, lodging, visa extension and work permission etc. for their trip							
5.The offer is based on 1USDzRMB6.3							

5. Përshkrimi i proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit

Ne kete aktivitet nuk do te kete asnje lloj procesi ndertimor, projekti eshte ekzistues dhe ne funksion me nje kapacitet te prodhimit te energjis prej 1600 KW dhe kerkon te shtoje kapacitet duke nderruar nje nga paisjet e tij operuese konkretisht do te zevendesoje gjeneratorin e vjeter me nje te ri duke rritur ne kete menyre kapacitetin me 380 KW pra ne total kapaciteti i HEC Selces do te shkoje ne 1980 KW.

Lenda e pare ne kete aktivitet eshte uje i cili merret nga dy vepra te ndyshme qe jane Lumi Cem i Selces dhe perroi i Sllapit sipas lejeve qe subjekti Selca Energji disponon. (lejet e ujit bashkengjitur ne aplikim)

- ✓ Burimit gjenerues nuk vë në rrezik sistemin elektroenergjetik, nuk ndikon në jetën dhe shëndetin e banoreve, jep kontribut në reduktimin e emetimeve të gazrave të efektit serë dhe nuk ka ndikim në mjedis.
- ✓ Si produkt përfundimtar ne kete aktivitet do te kemi prodhimin e energjise elektrike me nje kapacitet prej 1980 KW.

6. Informacion për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rruget ekzistuese të aksesit apo nevojen për hapje të rrugeve të reja

Zona në të cilën zhvillohet projekti i HEC Selcës ka një infrastrukturë rrugore ekzistuese, dhe nuk ka nevojë për hapje të rrugeve të reja.

Ne kete aktivitet do te prodhohet energji elektrike e cila me pas do te shpendahet ne rrjet per furnizimin e zones por jo vetem me energji. Persa i perket furnizimit me uje ne kete lloj aktiviteti uje perdoret si lende e pare dhe do te merret nga dy vepra marrje sipas te dhenave teknike qe subjekti disponon ne lejet perkatese.

7. Programi për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit

Aktiviteti në fjale siç e kemi përmendur edhe më sipër është ekzistues dhe në të nuk do të kryhet asnjë lloj punimi ndërtimor. Në këtë aktivitet do të bëhet vetëm zëvendësimi i një gjeneratori të vjetër me një të ri duke rritur kështu edhe prodhimtarinë nga 1600 KW në 1980 KW. Pajisja që do të zëvendësohet ndodhet brenda godinës ekzistuese të HEC-it.

Përsa i përket funksionimit të HEC Selcës ai do të vazhdojë të funksionojë për qatë kohë sa dhe burimi ujor që është lenda e parë për funksionimin e këtij projekti të ekzistojë. Nëse aktiviteti në fjale do të vendosi për mbarim të funksionimit do të bëhet çdo gjë sipas rregullave dhe procedurave përkatëse, duke zbatuar bazën ligjore që do të jetë në fuqi.

8. Lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji)

Duke qënë se në këtë aktivitet nuk do të ketë asnjë lloj procesi ndërtimor, nuk do të ketë asnjë përdorim të lëndëve të para për ndërtim. HEC Selca është aktivitet ekzistues dhe është në operim prej vitesh.

9. Informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zonës së projektit

Zona ku ndodhet hidrocentrali Selcës bën pjesë e Bashkisë Malësi e Madhe, Qarku Shkodër. Në afërsi të zonës së aktivitetit nuk ka projekte të tjera ekzistuese të cilat mund të ndikohen nga projekti në fjalë dhe pse siç edhe e kemi përmendur edhe HEC Selca është ekzistues dhe ka vite që operon, dhe është hidrocentral privat.

10. Informacion për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret

Përzgjedhja e alternativës më të mirë për realizimin e një projekti të caktuar është një nga detyrat kryesore të projektuesve. Hartimi i projektit si dhe përzgjedhja e alternativës më të mirë kryhet nga ekspertët e fushave përkatëse si Inxhinier Hidroteknikë, Inxhinier Gjeodet, Inxhinier Mjedis, Biolog etj. Më pas është diskutuar me investitorin dhe është përzgjedhur alternativa më e mirë. Për të arritur në një përfundim të saktë duhen analizuar disa faktorë si:

- ✓ Topografia e vendit ku do zhvillohet projekti
- ✓ Zonat me rëndësi kombëtare në afërsi të tij
- ✓ Prurjet e lumenjeve dhe përrenjëve
- ✓ Lloji i turbinave që përdoren

Duke qënë se hidrocentrali i Selcës është ekzistues këto gjëra janë marrë parasysh në momentin fillestar të ndërtimit të tij. Në këtë fazë aktiviteti vetëm do të ndryshojë një paisje (gjenerator) për të rritur efikasitetin dhe prodhimtarinë nga 1600 KW në 1980 KW. Këtu mund të theksojmë edhe faktin që HEC Selca është hidrocentral privat i cili ndodhet në Zonën Kadastrale Nr. 3278, me numër pasurie 10 dhe për këtë disponon edhe Vërtetim Hipotekor.

11. Të dhëna për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasi të ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre


Ky projekt bazohet në shfrytëzimin e energjisë së ujit për prodhimin e energjisë elektrike. Gjatë fazës së funksionimit të këtij hidrocentrali, në rrjedhën e lumit Cem i Selcës dhe përroit të Sllapit është e nevojshme vetëm energjia e ujit, e cila konsiderohet një energji e pastër dhe miqësore me mjedisin. Pra në këtë aktivitet përveç ujit nuk ka përdorim të lëndëve djegëse.

12. Aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj

Për zbatimin e projektit hidroenergjetik të subjektit SELCA ENERGJI sh.p.k i cili kërkon të bëjë zëvendësimin e një paisje brenda godinës ekzistuese të HEC-it (gjenerator) për të rritur prodhimtarinë e energjisë elektrike nga 1600 KW në 1980 KW nuk nevojiten aktivitete të tjera ndihmëse si kampe apo rezidenca banimi për punëtorët. Zëvendësimi i gjeneratorit të vjetër me gjeneratorin e ri është një proces pune që nuk kërkon kohëzgjatje dhe numër të madh punonjësish.

13. Informacion i detajuar për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/licensimin e projektit

SELCA ENERGJI SHPK duke qenë se disponon një HEC i cili është ekzistues dhe në operim disponon disa leje/autorizime dhe licenca për zhvillimin e këtij aktiviteti. Vendimi për VNM Paraprake do të shërbejë subjektit për shtimin e kapacitetit nga 1600 KW në 1980 KW. Lejet/licensat/autorizimet përkatëse bashkëngjitur si më poshtë:


REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E DREJTESISE
 Zyra Qendrore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajteshme
 Zyra Vendore e Regjistrimit te Pasurive te Paluajteshme Malesi e Madhe

V E R T E T I M NGA DOKUMENTET HIPOTEKOR

Vertetohet se ne regjistrin hipotekor me nr. 31 date 10.12.2010
 Figuron e regjistruar ne pronesi te

Emri	Atesia	Mbiemri	Pjesa
<u>"SELCA ENERGJI"</u>			
<u>Shpke</u>			<u>1-1</u>

Pasuria me Nr. 10 e ndodhur ne Zonen Kadastrale 3278 me
 Sipërfaqe 2553,2 m2 ne adresen SELCA
 Malesi e Madhe ne zerin kadastral H.E.C. 1056,5 m² 1871 objekt.
1486,7 m² s.p. funksionale.

Kufizimet e pasurise jane :

V <u>WCP HARTES</u>	L <u>MAI</u>
J <u>HOL</u>	P <u>HAI</u>

Origjina e regjistrimit te pasurise se paluajteshme :

Nr. HIP. <u>86</u> date <u>28.05.2002</u>	Nr. HIP. _____ date _____
Nr. HIP. _____ date _____	Nr. HIP. _____ date _____
Nr. HIP. _____ date _____	Nr. HIP. _____ date _____

Barre mbi pasurine MUE KA

Komente nga regjistruesi KONTROJE SHKURIMI
Nr. 771 faza 406 vol 01 dt 28.03.2019


Ky vertetim eshte i vlefshem i shoqeruar me Harte Treguese te Regjistrimit Provizor


Ky formular miratohet per vertetimin
 E pronesise deri ne perfundimin e
 Regjistrimit Filialtar sipas
 Ligjit nr. 7843 date 13.07.1994

Vertetimi i pronesise kesohet
 kerkeses Nr. _____
 Date _____ paraqitur ne ZVRPP

REGJISTRUES
[Signature]
[Signature]

DATE 24.03.2021








REPUBLIKA E SHQIPËRIE
AGJENCIA SHTETËRORE E KADASTRËS

FRAGMENT I HARTËS KADASTRALE

ZONA KADASTRALE:	3278	KODI UNIK:	_____
NUMRI PASURISË :	10	INDEX I HARTËS:	K-34-52-(116-A,B) K-34-52-(116-C,D)

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE



SH 1:10 000

DREJTORI
(Emer Mbiemer)

Data e lëshimit 28 / 09 / 2022

Ardian
Todhri

Digitalizim dhe
Kartografi
Data: 2022.09.28
M:142-0707

SHPJEGUES	
	PARCELA
	NDERTESA

Nr. 1729 Prot.Tiranë, më 01/03 2022**Lënda: Kthim pergjigje**

Referuar kërkeses tuaj me Nr.1729 Prot. dt. 21.02.2022 në të cilën kërkonti "Kerkese per shprehje mendimi per shtim fuqie " ju bejme me dije se:

Shoqëria OSSH shpreh mendimin për HEC Selca (I cili është licensuar me vendim të bordit të ERE nr 114 dt 07/10/2013)

Linja Ajrore (LATM) e Fiderit të Kelmendit është një linjë që shtrihet në një zonë rurale të Theth dhe është ndërtuar që në vitin 1970 ,ka shumë degezime dhe me percjelles te te gjitha seksioneve ALC 16,25,35, dhe 50 mm.

Në vitin 2020 është bërë fuqizimi I Transf Te Fuqise në N/ST e Vukpalajve dhe një segmenti të linjes I është bërë në ndryshimi I seksionit të percjellesit.

Sa me sipër shoqëria OSSH shpreh opinionin e saj se Hec Selca mund të shtojë 380 kW kapacitetin e saj,por në rastet që do të cenohet rrjeti për shkak të gjendjes së amortizuar , kapaciteteve të kufizura dhe nivelete e tensionit jashtë kufijve të lejuar do të ketë kufizime prodhimi sa here të lind e nevojshme.

Duke ju uruar punë të mbarë,
Me konsideratë,

Petra Lika
Administrator

OSSH sh.a.



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE
Bordi i Komisionereve



VENDIM

Nr. 114 Datë 07.10.2013

PËR

**MODIFIKIMIN E LIÇENSËS SË SHOQËRISË "SELCA ENERGJI"
SH.P.K ME NR. 102, SERIA PV10P PËR "PRODHIMIN E ENERGJISË
ELEKTRIKE" NGA HEC "SELCË", TË MIRATUAR ME VENDIMIN E
BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-S NR 39, DATË 05.05.2010**

Në mbështetje të neneve 9 dhe 19, të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", të ndryshuar, pikat 2.3 dhe 2.4 të "Liçensës për Prodhimin e Energjisë Elektrike", si dhe neneve 13; 14 pika 2; 15 pikat 1, 2 /b, 3, 4; të "Rregullores për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave", të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr.108, datë 09.09.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 07.10.2013, mbasi shoqërtoi aplikimin e shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k për ndryshimin e liçensës Nr. 102, Seria PV10P, për kryesjen e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike, lëshuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 39, datë 05.05.2010 dhe informacionin e Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit,

Konstatohet se:

Aplikimi i shoqërisë "Selca Energji" sh.p.k, plotëson kërkesat ligjore siç kërkohet nga "Rregulloja për procedurat e liçensimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të liçensave" si më poshtë:

- **Neni 15, pika 4, gërma "a"**: Informacioni me shkrim ku janë shpjeguar arsyet e kërkesës për modifikimin e liçensës.
- **Neni 15, pika 4, gërma "b"**: Vendimi me shkrim i organeve drejtuese të të liçensuarit të cilat shprehin vullnetin për të kërkuar modifikim liçense.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i Komisionerëve të ERE-s,

Vendosi:

1. Të modifikojë licensën me nr.102, Seria PV10P, për Prodhimin e Energjisë Elektrike nga Hec "Selcë" me fuqi 400 KW, të miratuar me Vendimin e Bordi i Komisionerëve Nr. 39, datë 05.05.2010.
2. Fuqia e instaluar e Hec "Selcë", nga 400 KW të bëhet 1600 KW.
3. Drejtoria e Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**Kryetari në detyrë
Shkëlqim Bozgo**



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE



LIÇENCË
PËR
PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Seria: PV10P

Numri i Liçencës: 102

Data e Hyrjes në Fuqi: Vendimi i Bordit të Komisionerëve të ERE-s Nr.39 dt.05.05.2010

Liçenca i jepet: " Selca Energji " sh.p.k.

Kodi Fiskal: K98510701M

Bazuar në autoritetin që i është dhënë në Pjesën e Tretë të Ligjit Nr. 9072, datë 22.05.2003 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", Enti Rregullator i Energjisë ("ERE") i jep këtë Liçencë për Prodhimin e energjisë elektrike ("Liçenca"), Personit të lartpërmendur, i quajtur "I Liçensuari", subjekt i Kushteve të kësaj Liçence. Kjo Liçence hyr në fuqi në datën e shkruar më lart dhe do të vazhdojë të jetë në fuqi për një periudhë prej **30 (tridhjetë)** vjetësh, në rast se nuk përfundohet ose pezullohet nga ERE-ja në përputhje me Kushtet e Liçencës të përfshira këtu.

Kryetari i ERE-s
BUJAR NEPRAVISHTA

REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

V E N D I M

Nr. 6 Date 26.07.2011

**"PER TRANSFERIMIN E LEJES TE PERDORIMIT TE
REZERVES UJORE SHOQERISE "WTS ENERGJI".**

Ne mbështetje të nenit 18 "Dispozita të përbashkëta për Lejet, autorizimet dhe koncesionet për përdorimin e ujit", gërma a, "Jane personale dhe nuk mund të transferohen pa miratimin e autoriteteve përkatëse të ujit" të ligjit nr.8093, dt. 21.03.1996 "Për rezervat ujore", bazuar në relacionin e paraqitur nga A.U.B. Drin-Bune, Keshilli i Basenit Ujëmbledhës Drin-Bune :

VENDOSI :

- 1- Te miratojë kërkesën për transferim të Lejes të Përdorimit të Rezerves Ujore për hidrocentralin e Selces, nga shoqëria "WTS Energji" sh.p.k. tek shoqëria "Selca Energji" sh.p.k.
- 2- Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune për ndjekjen e procedurave përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

Sekretari

Muhamet MUÇA



Kryetari

Sekretari Përgjithshëm i Prefekturës

Fatbardh SHEQI





REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE
SHKODER

AUTORIZIM I POSACEM

PER PERDORIM REZERVE UJORE
PER PRODHIM HIDROENERGJIE
Nr. 3, date 06.04.2010.

- A. **EMRI, ADRESA E MARRESIT TE AUTORIZIMIT TE POSACEM :**
Shoqeria " WTS ENERGJI" sh.p.k.
Me administrator Kole GJONI.
Me seli ne qytetin e Tiranes, Rruga S. Pasha.
- B. **OBJEKTI I LEJES DHE SPECIFIKIMET E TIJ: Burimi Ujor.**
Perdorim i burimit uJOR. Lumi Cemi i Selces.
Baseni Ujembledhes : Drin – Bune, rrethi Malesi e Madhe, Komuna Kelmend.
Burimi uJOR eshte ne pronesi shteterore dhe ka keto specifikime :
Hidrocentrali **HEC Selce** .
- Vepra e marrjes do te ndertohet ne kuoten Z: + 520 m, ndersa ndertesa centralit do te ndertohet ne kuoten Z: + 460 m.
- Prurja mesatare: $Q = 2.7 \text{ m}^3/\text{sek}$.
- C. **SASIA E UJIT QE JEPET PER PERDORIM: $Q = 2.562 \text{ m}^3/\text{sek}$.**
- Vendshkarkimi i ujrave te perdorura : Lumi Cemi i Selces.
- D. **AKTIVITETI PER TE CILIN DO TE PERDORET KJO REZERVE UJORE ESHTË :** Prodhim hidroenergjie, me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.
- E. **KY AUTORIZIM I POSACEM ESHTË I VLEFSHME DERI ME DATE: 05.04.2040.**
Marresi i ketij autorizimi te posacem eshte i detyruar te plotesoje te gjithë kushtet qe i bashkengjiten ketij autorizimi te posacem dhe vendimit te K.B.U. Drin - Bune nr. 3, date 06.04.2010.

KRYETAR

**I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE
SHKODER**



Adresa: Qendra e Transferimit te Teknologjive Bujqesore. Kati 3^o



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETAR I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN- BUNE

V E N D I M
 Nr. 7 Date 10.06.2013

"PER MIRATIMIN E LEJES PER PERDORIM TE
REZERVES UJORE PER PRODHIM HIDROENERGJIE".

Bazuar ne ligjin nr. 8093 dt. 21.06.1996 "Per rezervat ujore", neni 18 germa dh, dhe te vendimit nr. 87 dt. 16.01.2008 te K.M., "Per disa ndryshime dhe shtesa ne vendimin nr. 27 dt. 19.01.2007 te K.M."Per miratimin e rregullave te vleresimit dhe te dhenies se koncesioneve", te ndryshuar, ne Kreun XI, piken 9,"Shpallja e fituesit dhe negociimi i kontrates",si dhe te V.K.M. nr. 708 dt. 21.05.2008, me propozim te A.U.B. Drin-Bune, Keshilli i Basenit Ujembledhes Drin-Bune :

VENDOSI :

- 1- Miratimin e Lejes per Perdorim te Rezerves Ujore, perroi i Sllapit komuna Kelmend, Qarku Shkoder per " Hidrocentralin e Selces" shoqerise "SELCA ENERGJI " sh.p.k. per prodhim hidroenergjie, nga kuotat e vepres te marrjes ne perroin e Sllapit + 878 m, deri ne kuoten + 470m, ku eshte e ndertuar godina centralit.
Prurja qe do perdore shoqeria eshte $Q = 0.3m^3/sek$, ndersa prurje mesatare e perroit eshte $Q = 0.85 m^3/sek$.
Shoqeria ka privatizuar kete hidrocentral ne vitin 2004 nga Agjensia Kombetare e Privatizimit.
- 2- Leja e perdorimit te rezerves ujore per prodhim hidroenergjie jepet me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe nevojave te bujqesise ne zone.
- 3- Ngarkohet A.U.B. Drin-Bune per zbatimin e ketij vendimi.

PER KESHILLIN E BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

Sekretar

Muhamet Muça



Kryetar

Fatbardh Sheqi



REPUBLIKA E SHQIPERISE
KESHILLI KOMBETARE I UJIT
KESHILLI I BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE

LEJE

PER PERDORIM REZERVE UJORE
PER PRODHIM ENERGJIE
Nr.7 date 10.06.2013.

- A- **Emri dhe adresa e marresit te "Lejes per Perdorim te Rezerves Ujore".**
Shoqerise "Selca Energji" sh.p.k.,
me administrator z.Sebastian Pjetri,Shkoder.
- B- **Objekti i lejes dhe specifikimet e tij.**
Burimi ujq,Perroi Sllapit.
Baseni Ujembledhes Drin – Bune, RrethiMalesi e Madhe. Qarku Shkoder.
Burimi ujq eshte ne pronesi shtetore.
Hidrocentrali "Selces".
Veprat e marrjes do te ndertohet ne perroin Sllapit, ne kuoten + 878m.
Ndertesa centralit do te ndertohet ne kuoten Z- +470 m.
Prurja mesatare $Q= 0.85$ m3/sek. Subjekti do shfrytezoje $Q= 0.3$ m3/sek.
- C- **Aktiviteti per te cilin do te perdoret kjo rezerve ujore eshte:**
Prodhim energjie , me kusht qe te mos kufizohet furnizimi me uje te pijshem dhe
nevojat e bujqesise ne zone.
- D- **Kjo leje eshte e vlefshme deri me date: 09.06.2043.** Marresi i kesaj leje eshte i detyruar
te plotesoje te gjitha kushtet qe i bashkengjiten kesaj leje dhe vendimit te K.B.U. Drin-Bune
nr. 9 dt.10.06.2013.

KRYETARI

KESHILLIT TE BASENIT UJEMBLEDHES DRIN-BUNE
Sekretari I pergjithshem I prefektures



14.Të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës ku do të zhvillohet projekti

Përsa i përket përdorimit ekzistues të tokës ku do të zhvillohet projekti, mund të themi që kemi të bëjmë me një aktivitet ekzistues i cili është në operim dhe konkretisht kemi të bëjmë me hidrocental, godina e të cilit dhe të gjitha paisjet e nevojshme për funksionimin e tij janë ekzistuese, subjekti Selca Energji kërkon të rrisë kapacitetin e prodhimit të energjisë elektrike e cila do të bëhet vetëm me anë të zëvendësimit të një paisje konkretisht gjeneratorit gjë e cila do të çojë në rritje të prodhimtarisë nga 1600 KW që prodhon tani në 1980 KW.